



TV Syri Vision
Elbasan DOBRUNA
Drejtor
Gjakovë

Ankesa Nr. 2017/48 KPM vs TV Syri Vision
Ref:1708/784/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/48 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV Syri Vision (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur më Licencë të KPM-së me datën 12 mars 2010. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM gjatë kohës së fushatës zgjedhore ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, me theks të veçantë prezencën e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.
4. KPM, bazuar në monitorimet që janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spotin politik të AAK-së në të cilin janë përfshirë fëmijët.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët dhe me këtë ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”

Vendimi

6. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

8. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
9. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë